

Informacion-pyetëor për pacientët

MR-Artrografi



MEDIZINISCH
RADIOLOGISCHES
INSTITUT

Shumë e nderuara paciente, shumë i nderuar pacient

Ju nga mjeku Juaj jeni udhëzuar te ne për një kontroll special me Rezonancë Magnetike (MR) të njërit kyç. Validiteti i këtij kontrolli pas një injektimi të lëndës së kontrastit në kyç është dukshëm më i mirë sesa pa këtë injektim. Lënda e kontrastit (mjeti kontrastiv) në kyç i dallon (identifikon) gjendjet e sëmura (patologjike), të cilat përndryshe shpesh ngelin të fshehura. Kështu, për shembull, do të mund të identifikohen tashmë të çara shumë të vogla në damarë (dell, lak) dhe në kërce.

Rrjedha e kontrollit

Injektimi i lëndës kontrastive bëhet para kontrollit MR në një hapësirë tjetër. Arsyeja për këtë qëndron në atë se shpimi duhet të kryhet nga radiologu me saktësi (duke përdorur një aparat të rëntgenit ose aparat për radioskopi).

Injektimin e bën radiologu pas dezinfeksionit të vendit të shpimit dhe të mbulesës së sterilizuar. Gjilpërat që përdoren kryesisht janë më të holla sesa ato të cilat si zakonisht përdoren për marrjen e gjakut. Pas shpimit (hapjes) të lëkurës në të shumtën e rasteve pason një mpirje e vendit përkatës (anestezi lokale). Pastaj gjilpëra në etapa shtyhet përpara në drejtim të kyçit. Sapo të arrijë gjilpëra në kyç, injektohet pak mjet kontrastiv për rëntgen, me qëllim që pastaj mjeti kontrastiv për MR të mbërrijë sigurt në kyç. Gjatë injektimit të lëndës së kontrastit për MR Ju mund të ndieni në kyç një ndjenjë të presionit (shtrëngimit).

Pas largimit të gjilpërës, Ju do të shoqëroheni deri te aparati MR nga një asistente rëntgeni. Kontrolli MR zgjat rreth 25 deri 30 minuta; Ju me atë rast, mundësisht nuk duhet të lëvizni.

Çfarë efektsh anësore mund të shfaqen?

- Disa orë pas kontrollit, në kyçin e kontrolluar mund të shfaqen dhimbje, të cilat mund të zgjasin më së shumti 1-3 ditë.
- Alergjitë në krahasim me injektimin e lëndës së kontrastit në mënyrë venoze, dukshëm janë më të rralla.
- Rrallë herë mund të formohet një hematomë.
- Infeksionet janë shumë të rralla (probabiliteti më i vogël se 1:10'000).

Mbiemri:	<input type="text"/>
Emri:	<input type="text"/>
Data e lindjes:	<input type="text"/>

Ju lutemi t'u përgjigjeni pyetjeve në vijim

	Po	Jo
A merni hollues të gjakut (kundërpiksës)?	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
A vuani momentalisht nga ndonjë infeksion?	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

Unë i kam kuptuar informacionet, në të gjitha pyetjet jam përgjigjur me ndërgjegje të plotë dhe jam dakord me kryerjen e kontrollit. **Vetëkuptohet se Ju në çdo kohë mund të na parashtroni pyetje, si para ashtu edhe gjatë kohës së kontrollit.**

Data:	<input type="text"/>	Nënshkrimi i pacientes/pacientit:	<input type="text"/>	Radiologu:	<input type="text"/>
-------	----------------------	-----------------------------------	----------------------	------------	----------------------

